



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
-AUTORITETI I KONKURENCËS-
Komisioni i Konkurrencës**

V E N D I M

Nr. 122 Datë 17.09.2009

Mbi

**autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet shitblerjes së 100 % të
kuotave të shoqërisë Albanian AirLines MAK SH.p.k. nga shoqëria Advanced
Construction Group Sh.p.k**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e :

- Znj. Lindita Milo (Lati) Kryetar
- Znj. Servete Gruda Anëtar
- Z. Koço Broka Anëtar
- Znj. Rezana Konomi Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 17. 09.2009, shqyrtoi çështjen me :

Objekt: Autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet shitblerjes 100% të kuotave të shoqërisë Albanian AirLines MAK SH.p.k. nga shoqëria Advanced Construction Group Sh.p.k

Baza ligjore: Ligji nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, neni 24, shkronja d, nenet 10-12 dhe neni 59, në veçanti Kreu III “Përqendrimet e ndërmarrjeve” nenet 53-56, 58, Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”, Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit dhe mundësinë për njoftim të thjeshtuar” dhe Formulari “Për njoftimin e përqendrimit”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të raportit mbi njoftimin e përqendrimit dhe relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm,

V Ë R E N S E:

I. Transaksioni dhe përqendrimi

Transaksioni është realizuar me anë të Kontratës “Për shit-blerje kuotash” e nënshkruar ndërmjet palëve Albanian AirLines MAK SH.p.k dhe Advanced Construction Group Sh.p.k, më 4 Korrik 2008. Në këtë transaksion shitësi

përfaqësohet nga ortaku i tij, shoqëria Mohammed Abdulmeohsin Al-Kharafi & Sons for Geberal Trading, General Contracting and Industrial Struc E.L.L e cila vepron në emër dhe për llogari të shoqërisë Albanian AirLines.

Kontrata është lidhur në mirëkuptim dhe bashkëpunim nga palët me qëllim transferimin e totalit të kuotave të shoqërisë Abanina AirLines të zotëruara nga ortaku i vetëm Al-Kharafi Group në shoqërinë Advancet Costruction.

Shoqëria Advanced Construction Group Sh.p.k (blerësi) me realizimin e transaksioni është bërë pronar i 100% të kuotave të transferuara, duke fituar cilësinë e ortakut të vetëm të shoqërisë Albanian AirLines sëbashku me të gjitha të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga pronësia e tyre.

Blerësi do të ruajë dhe do të ndihmojë në zhvillimin e profilit tregtar të shoqërisë Albanian AirLines⁽¹⁾ me anë të strukturës së aktivitetit ekonomik të parashikuar në aktin e themelimit në liçencë dhe aktivitete të tjera të lejuara⁽²⁾. Pra edhe pse në këtë rast kemi të bëjmë me një zëvendësim pronësie, përse i përket aktivitetit dhe veprimtarisë së shoqërisë Albanian AirLines situata do mbetet e njëjta pasi:

- (i) ky zëvendësim pronësie, i cili sjell ndryshim në cilësinë e kontrolluesit (ortakut të vetëm kontrollues);
- (ii) nuk sjell asnjë pasojë në politikën menaxheriale dhe në kushtet e tregut.

Vlera e transaksionit është 13.000.000 USD dhe do të shlyhet nga blerësi me burimet e veta financiare dhe sipas modaliteteve të përcaktuara në Nenin 3 të kontratës për shit-blerje kuotash.

Ky transaksioni nëpërmjet të cilit realizohet në mënyrë të drejtëpërdrejtë përfundimi i kontrollit, sjell ndryshime mbi një bazë të qëndrueshme të kontrollit, në kuptim të nenit 10, pika 1 dhe 2, konsiderohet përqendrim⁽³⁾.

Transaksioni i realizuar është objekt kontrolli dhe duhet të njoftohet për t'u autorizuar nga Komisioni i Konkurrencës, sepse përmbush në mënyrë kumulative edhe kushtin e parashikuar në pikën 1, shkronja a) dhe b) të nenit 12⁽⁴⁾ të Ligjit.

¹ Albanian AirLines ka autoritet të plotë dhe kompetencë për të vepruar në përputhje me objektin e aktivitetit të saj dhe për të zotëruar pasuritë e aktivitetit në pronësinë e saj. Shoqëria është kualifikuar dhe e liçencuar sipas ligjeve për të ushtruar aktivitetin e saj.

² Në bazë të nenit 6 të kontratës për shit-blerje kuotash, ku parashikohen garancitë dhe deklaratimet e palëve.

³ Transaksioni është në përputhje me nenin 3, pika 1 të Rregullores No 139/2004 dhe Njoftimin e Konsoliduar të Komisionit Evropian.

⁴ a) Xhiroja e të gjitha ndermarrjeve pjesëmarrëse së bashku në tregun ndërkombëtar është me shumë se 70 miliardë leke, ose xhiroja e të gjitha ndermarrjeve së bashku, në tregun e brendshëm është me shumë se 800 milionë leke dhe

b) xhiroja e të paktën një ndermarrjeje pjesëmarrëse në tregun e brendshëm është me shumë se 500

II. Palët në transaksion

Shoqëria **Advanced Costruction Group** (këtu e më poshtë referuar si "**Advanced Costruction**"), në cilësinë e **blerësit**, është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar dhe që funksionon sipas legjislacionit shqiptar, me seli në adresën: Rr. Dëshmorët e 4 Shkurtit "Green Park", K 6, Po. 19, Tiranë. Objekti i shoqërisë është (i) Import-eksport, tregti me shumicë e pakicë të artikujve industrialë, etj. (ii) agjenci turistike, transport udhëtarësh, brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, si dhe agjenci ajrore.

Shoqëria **Albanian AirLines MAK Sh.p.k** (këtu e më poshtë referuar si "**Albanian AirLines**"), në cilësinë e **shitësit**, është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar dhe që funksionon sipas legjislacionit shqiptar, me seli në adresën: Rr. Dëshmorët e 4 Shkurtit "Green Park", K 2, Po. 19, Tiranë. Objekti i shoqërisë është transporti i mallrave dhe i pasagjerëve me mjetet e transportit ajror, të blera prej saj, si dhe të marra ose të dhëna me qera, veprimtari të agjencisë të udhëtimit e të shitjes së biletave, aktivitet magazinues e spedicioner si dhe administrim, operim e akomodim i pasurive të paluajtshme në aeroporte që i shërbejnë kësaj veprimtarie, veprimtari riparuese, pastruese e magazinuese avionesh ose pajisjeje të tyre.

Shoqëria Albanian AirLines është në pronësi të ortakut të vetëm të shoqërisë **Mohammed Abdulmeohsin Al-Kharafi & Sons for Geberal Trading, General Contracting and Industrial Struc (Al-Kharafi Group)**, një shoqëri e krijuar dhe që funksionon sipas të drejtës kuvajtiane, e regjistruar në Regjistrin Tregtar të Kuvajtit me Nr. 53472 regjistrimi tregtar dhe me Nr. 38925 regjistrimi, që prej vitit 1993. Aktiviteti i shoqërisë ushtrohet kryesisht në fushën e tregtisë dhe të ndërtimit.

III. Xhiro e ndërmarrjeve

Xhiro në tregun ndërkombëtar e shoqërisë Mohamed Abdulmohsin Al Karafi & Sons General Trading , General Constarcting and Industrial Structures CO Ë.L.L , për vitin 2007 është xxxxx Dinarë Kuvajtian⁵ = xxxxx miliard lekë.

Xhiro totale në tregun e brendshëm është xxxxx miliardë e xxxxxx milion lekë ku:

- Albania Airline, për vitin 2007, ka realizuar një xhiro prej xx miliardë lekë

milione leke

⁵ Burimi për kursin e këmbimit është faqja internetit www.xe.com , 1 dinar kuvajtjan KWD = 399 lekë ALL

- Advanced Construction Group, për vitin 2007, ka realizuar një xhiro prej xxxxx milion lekë.

IV. Tregu përkatës i produktit:

- Shoqëria Advanced Constructin Group Shpk ushtron aktivitetin e saj ne fushën e tregtisë së artikujve të ndërtimit, industriale, elektrike, makineri ndërtimi. Gjithashtu dhe në agjensi turistike, transporti udhëtarësh brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë si dhe agjensi ajrore.
- Shoqëria Albanian Airline ushtron aktivitetin e saj në transportin ajror të mallrave e të pasagjerëve, agjensi udhëtimi e shitje biletash etj.

Meqënëse shoqëritë që janë pjesë e këtij përqendrimi, ushtrojnë veprimtarinë e tyre në tregje komplet të ndryshme, atëherë për përcaktimin e tregut përkatës do i referohemi tregut të shoqërisë e cila është objekt i ndryshimit të kontrollit.

Treg përkatës të produktit do të konsiderojmë shërbimin e transportit ajror të pasagjerëve dhe transportit ajror të kargos.

Tregu përkatës gjeografik: Për vlerësimin e këtij transaksioni dhe efektet që do të sjellë në treg, treg përkatës gjeografik do të konsiderohet tregu i brendshëm/territori i Republikës së Shqipërisë.

1. Shërbimi i transportit ajror të kargo

Albania Airlines është aktive në ofrimin e këtij shërbimi, me pjesë tregu⁽⁶⁾ 4 % për vitin 2007 dhe rreth 2 % për vitin 2008.

2. Shërbimi i transportit ajror të pasagjerëve

Albanian Airlines është aktive në ofrimin e shërbimeve të transportit ajror të pasagjerëve me fluturimet drejt qyteteve si Frankfurt, Bolonja, Torino, Londër, Stamboll, duke arritur një numër në total prej 133 453 pasagjerësh në vit⁽⁷⁾, për vitin 2008 dhe një pjesë tregu prej 11 %.

V. Analiza e konkurrencës

Në tregun e brendshëm të transportit ajror të pasagjerëve bëjnë pjesë rreth 12 shoqëri ajrore, të cilat operojnë kryesisht në distanca të shkurtra, nëpërmjet aeroportit të vetëm në Tiranë. Në vitin 2008 u realizuan rreth 19.194 fluturime dhe rreth 1 267 041 pasagjerë.

⁶ Burimi : Sektori i Studimeve dhe Analizës.

⁷ Burimi: Sektori i Analizës dhe Studimeve, të dhëna për vitin 2008

Struktura e tregut të brendshëm, karakterizohet nga konkurrentë të tjerë me pjesë të konsiderueshme tregu si shoqëria Belle Air me një pjesë prej 37% të tregut, Alitalia me 17% të tregut, Austrian Airlines 8% të tregut, Lufthansa 6% të tregut, Turkish Airlines 6% të tregut, Malev 4% të tregut, British Airways 4% të tregut etj.

Pas realizimit të përqendrimit, struktura e tregut nuk ndryshon, pasi në kuptim të nenit 10, pika 1, gërma b kemi zëvendësim të pronësisë dhe blerësi do të ruajë dhe do të ndihmojë në zhvillimin e profilit tregtar të shoqërisë Albanian Airlines.

Sa më lart, përqëndrimi i realizuar nuk ndryshon strukturën e tregut pas përqendrimit dhe si pasojë nuk krijon apo forcon pozitën dominuese në tregun përkatës.

PËR KËTO ARSYE

Në bazë të nenit 24, shkronja d, dhe nenit 56 pika 1, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”:

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqëndrimin e realizuar nëpërmjet shitblerjes së 100% të kuotave të shoqërisë Albanian AirLines MAK SH.p.k. nga shoqëria Advanced Construction Group Sh.p.k
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Servete GRUDA

(_____)

Anëtar

Koço BROKA

(_____)

Anëtar

Rezana KONOMI

(_____)

Anëtar

Lindita MILO (LATI)

K R Y E T A R E